REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr._____Prot. Maliq, më 25.07.2025

NJOFTIM

LËNDA: Mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Maliq

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ
KRYETARIT TË BASHKISË MALIQ

Të nderuar,

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* datë 17.12.2015, i ndryshuar, neni 53, *"Funksionimi i këshillit bashkiak"*, pika 4 dhe 5, neni 56 *"Kryetari i këshillit bashkiak"* pika 2 gërma "a", dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, *"Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq"* ju njoftojmë se mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Maliq do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të këshillit ditën e **premte , më datë 01.08.2025, ora 10:00** me këtë,

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.06.2025.
4.P-V "Për miratimin e përfituesve nga programi subvencioni i intresave të kredisë për strehim";
5. P-V"Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.129, datë 26.12.2024, *"Për miratimin e numurit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës së bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera, për vitin 2025"*;
6.P-V "Për miratimin e përditësimit të pjesshëm të listës së inventarit të pronave, të transferuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 524, datë 30.06.2010 "*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Gorë, të Qarkut të Korçës*";
7.P-V "Për miratimin e transferimit në pronësi të Bashkisë Maliq, të pasurive me numër 334 dhe 336, Zona Kadastrale 2965, fshati Pirg dhe përditësimin e pjesshëm të disa pronave, në listën e inventarit të pronave, të transferuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 826, datë 21.11.2012 "*Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Pirg, të Qarkut të Korçës*";
8.P-V "Për miratimin e planit lokal të manaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane të Bashkisë Maliq 2025-2035";
9.P-V "Për dhënie Tituj Nderi";
10.Shqyrtimi i kërkesave drejtuar Këshillit Bashkiak Maliq.
11.Diskutime të tjera.

- Informacion lidhur me *"Barometrin e Barazisë Gjinore, bashkia Maliq, viti 2024"*

Shënim: Mbledhjet e Komisioneve të Këshillit do të mbahen ditën e Mër me datë 30.07.2025 nga ora 10:00-13:00 Enjte si më poshtë:

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjiktë Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare. Pikat 5, 6, 7 e rendit të ditës.
z.Petrit Kupe, znj.Pranvera Begolli, znj.Marianthi Avrami, znj.Eglantina Balli, z.Andonaq Risto.

Komisioni i Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimit. Pika 4 e rendit të ditës.
z.Idlir Limllari, z.Ronaldo Skënderi, znj..Pranvera Begolli, z.Almir Elezi, z.Faslli Zholi,

Komisioni i Shërbimeve Publike, Transportit, Lëvizshmërisë Mjedisore, Parqeve dhe Rekreacionit, Parkingjeve. Pika 8 e rendit të ditës.
z.Idlir Limllari, z.Ilia Xhuti , znj.Rovena Terolli, znj.Albina Xhejo, z.Faslli Zholi

Komisioni i Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Dhënies së Titujve, Emërtimeve. Pika 9 e rendit të ditës.znj.Floreta Zaçe, znj.Daniela Ibarahim, z.Almir Elezi, z.Faslli Zholi, z.Server Xhuti

Ju falemnderit!

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI